



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHKITE
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-7418/21 datë:25.03.2021



Npi – 01/97 datë: 30.03.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 30.03.2021, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 30.03.2021 (e martë) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.01

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Komitetit, z.Rahman Kadrija, Anëtarët: znj.Fatmire Ferati, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, z.Ruzhdi Brahimi, dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri, Nga zyra për Informim z.Lulzim Sahiti; Nga njësi për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, z.Reshat Gashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i KPK-së z.Rahman Kadrija, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent, mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më: 02.03.2021,
2. Projektet për infrastrukturë në lagjet e komuniteteve gjatë vitit 2020,
3. Problemet dhe projektet në sferën e barazisë gjinore në komunë,
4. 8 Prilli-Dita e Komitetit Rom-aktivitetet,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më: 02.03.2021

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 02.03.2021.**

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Po kalojmë në shqyrtimin e pikës së tretë, deri sa të vjen zyrtari i urbanizmit, për ta prezantuar pikën e dytë të rendit të ditës.

Pika 3

Problemet dhe projektet ne sferën e barazisë gjinore në komunë

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike fjalën po ja kaloj Reshat Gashit.

z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore; Përshëndetje, unë prita që do të hapni ndonjë debat për këtë pikë. Nuk kam çka të përgjigjem, sepse unë probleme nuk kam vërejtë, por mund të flas për raportin. Problemi siç dihet është pandemia. Ndërsa sa i përket zgjedhjeve të fundit, janë organizuar mirë, dhe nuk ka pas ndonjë problem të theksuar për ta përmendur. Jam këtu për tu përgjigjur pyetjeve të juaja.

z.Ruzhdi Brahimi; Përshëndetje, faleminderit prej Reshatit për informatën. Ju po e shihni se far papunësie është, unë po kërkoj që këtijë Komiteti ti ofrohet një ndihmë financiare sado e vogël.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Sa i përket barazisë gjinore, sipas planit të punës e kemi paraparë edhe diskutimin për këtë temë, për me marrë informata shtesë. Sa po shoh nuk keni diçka tjetër më shumë në krahasim me atë që është raportuar në Kuvend. Problemi i barazisë gjinore edhe në komunën tonë, sillet në suazat e normales.

Pika 4

8 Prilli-Dita e Komunitetit Rom-aktivitetet

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, unë dua të informoj Komitetin se ne në Shtime nuk kemi të organizuar ndonjë aktivitet, por aktiviteti qëndror organizohet në Prizren, më 8 Prill, dhe po besoj se do të marrin pjesë shumë. Unë po kërkoj nga Komuna jonë që të na i mbulojë shpenzimet për transport.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Përshëndetje, sikurse edhe viteve tjera edhe në këtë vit ne u kemi ndihmuar në organizimin e këtijë aktiviteti, me një shumë financiare simbolike. Kështu që ne si Komunë jemi të gatshëm që të ju ndihmojmë si komunitet rom që ta festoni ditën e flamurit sa më mirë..

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, unë e shfrytëzoj rastin që komunitetit Rom të ua uroj 8 Prillin ditën e flamurit. E dimë që është kohë e pandemisë dhe duhet pas kujdes për mbrojtjen e shëndetit gjatë manifestimeve të tilla, mirëpo sido që të jetë ne e përkrahim këtë aktivitet.

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Unë dua të flas pak për aktivitetet e ZKKK-së, sepse kësaj radhe nuk është paraparë si pikë e veçantë. Si gjithëherë ne informatën e kemi të shkruar dhe do ta lexojë në pikat kryesore, pastaj nëse ka pyetje jamë i gatshëm të përgjigjem. (shih dokumentin).

z.Ruzhdi Brahimi; Unë dua të flas pak për varrezat e komunitetit ashkali në fshatin Rashincë. Në këto varreza janë të varrosur edhe familjarët e mi, por aty ka të varrosur edhe nga familjarët e familjeve Lami në fshatin Rashincë. Ne mundemi me shku me i pa ku janë këto varreza. Unë kërkoj që të ketë një mirëmbajtje më të mirë për varrezat.

znj.Fatmire Ferati; Përshëndetje, sa i përket legalizimit të pronave unë desha të ju pyes, se a keni bërë ndonjë njoftim për sa i përket komuniteteve pakicë, lidhur me legalizimin e pronave?

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Po, ka një njoftim të përgjithshëm. Mirëpo ndoshta ka nevojë për ndonjë njoftim të posaçëm për komunitetin pakicë, sepse ka mundësi që nuk e kuptojnë mirë, kështu që ne mund ta bëjmë edhe një njoftim të tillë.

z.Arton Demiri; Me Covid-19 kanë qenë të prekur edhe nëna ime Dashurie Demiri nga Shtimja, dhe mund të ju them se kemi pas shpenzime të shumta, mirpo e kemi kaluar mirë, sido që të jetë unë po kërkoj që me na ndihmuar pak ZKKK-ja.

z.Muhamet Ademaj; Sa i përket Covid-19 e di që nevojitet shpenzime të mëdha, për fat të keq Komuna jonë nuk po u del në ndihmë qytetarëve. Dikush duhet me u ndihmuar këtyre të prekurve me Covid-19, sepse kanë shpenzime por edhe janë taksapagues të Komunës tonë, pa marrë parasysh se cilit komunitet i takojnë. Unë e përkrahu Lulzim Sahitin - zyrtar për informim, që ka bërë shkrime dhe i ka bërë publike. Gjithashtu po kërkojë që Komuna të kujdeset më shumë për mirëmbajtjen e varrezave.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Ndoshta do të ishte mirë që njerëz në mbledhjen e Kuvendit të shtrohet çështja e mbulimit të shpenzimeve që janë bërë nga të prekurit me sëmundjen Covid-19.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Edhe unë e përkrahu kërkesën që tu ndihmohet personave që kanë qenë të prekur me Covid-19. Në fshatin Gjyrkovc janë tri raste të prekur me Covid-19.

znj.Fatmire Ferati; Shuma financiare prej 100.000€ janë ndarë nga Kuvendi për ndihma. Ne e dimë që ndihmat janë ndarë me pako ushqimore, me mjete të dezinfektimit etj, mirëpo kjo shumë është ndarë për vitin 2020. Sa i përket ndarjes së ndihmave e di shumë mirë, sepse edhe vet kamë qenë pjesëmarrëse në ndarjen e këtyre ndihmave. Nëse DSHMS-ja ka mjete të subvencioneve në dispozicion atëherë le të adresohet një kërkesë e tillë në DSHMS-ë.

z.Arton Demiri; Mua më ka ndodhë që i kamë hargjuar 1150 euro për me shëruar Nënë. Me një pako ushqimore nuk bëhet asgjë, duhet me bë diçka më shumë.


z.Muhamet Ademaj; Unë këtë çështje do ta ngris nesër në Kuvend, sepse e di që ka shpenzime të shumta.

z.Ruzhdi Brahimi; Unë kamë një pyetje për Ibrahim Demirin për sa i përket legalizimit të pronave. Qysh mundemi me i përkthyer tokat në emër tonin, kur e dimë që një numër i madh i tyre kanë blerë toka prej komunitetit Serbë, në formë paushalle apo me dëshmitarë. Tash dihet se ata kanë shkuar, ku mundemi me i gjetë që ti perkthejmë tokat në emrin tonë.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Unë nuk e di se qysh bëhet legalizimi, por e di që ka firma për me e treguar saktë se si mundë të kryhet ky legalizim.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija, mbledhjen e përfundoi në ora 14.55 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija

